



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Alban Beka udhëheqës ekipi dhe anëtareve Neslihane Mati dhe Arnisa Aliu, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	30
Shtojca II: Letër Konfirmimi	33

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përgatitur sipas kërkesave të kornizës për raportim financiar me përjashtim të keq klasifikimit të shpenzimeve dhe mangësive në shpalosjet e informatave në lidhje me pasuritë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet kontingjente.

Ministria e Shëndetësisë ka vendosur një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit por që ende nevojiten veprime shtesë për të përmirësuar menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve. Në menaxhimin e të hyrave si dobësi ishte pranimi i të hyrave kesh përtej limitit që e lejojnë rregullat financiare si dhe deponimi i tyre me vonesë në bankë.

Proceset e menaxhimit të shpenzimeve ishin përcjellur me mjaft mangësi. Mangësitë më të theksuara ishin në vlerësim të tenderëve dhe menaxhim të kontratave. Pasuritë, llogaritë e arkëtueshme si dhe obligimet gjithashtu nuk ishin raportuar në mënyrën e duhur.

Zbatimi i rekomandimeve mbetet ende sfidë për tu adresuar në të ardhmen në fushën e realizimit të buxhetit, menaxhimin e pasurive dhe raportimin e saktë të Llogarive të arkëtueshme.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të MSh-së gjatë gjithë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e MSh-së, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin:

Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se përmes vendimeve gjyqësore dhe planifikimit buxhetor Ministria ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 299,894€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Në këtë raport kjo çështje është trajtuar tek nënkapitulli 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Shëndetësisë është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Ministria e Shëndetësisë kishte shpenzuar 64% të buxhetit final për vitin 2019 që nënkupton një realizim jo të kënaqshëm në nivel të përgjithshëm. Niveli i ulët i shpenzimit të buxhetit ka pamundësuar arritjen e objektivave të përcaktuara për forcimin e kapaciteteve shëndetësore dhe rrjedhimisht edhe ka ndikuar në cilësinë dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Në kontekst të sistemeve financiare kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme me përjashtim të devijimeve sa i përket pranimit të pagesave mbi 10€ në arkë dhe vonesave në deponimi e tyre në bankë që ishte në kundërshtim me rregullat financiare, përderisa kontrollet e vendosura në fushën e shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm dhe veprime shtesë.

Fushat me probleme më të theksuara të shpenzimit ishin menaxhimi i financave që ndërlidhet me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve dhe realizimi i ulët i buxhetit, menaxhimi i kontratave përfshirë edhe vonesat në vlerësim të tenderëve si dhe niveli i pagesave me vendime gjyqësore që kishin rritur kostot krahasuar me borxhin kryesor.

Po ashtu, menaxhimi i pasurive nuk ishte në nivelin e kërkuar pasi që pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet me rregullat përkatëse, dhe se mangësi kishte edhe te prezantimi i llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve kontingjente.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Burimet e Fondeve	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Totali	39,863,808	40,979,946	26,153,128	64%	58,559,449	57,567,776
Granti i Qeverisë –Buxheti	31,366,871	27,751,165	20,953,471	76%	57,163,507	57,025,126
Te hyrat nga AKP	5,768,000	5,593,217	3,260,449	58%	0	0
Financimi nga Huamarrja	2,728,937	6,856,083	1,717,078	25%	952,066	443,041
Donacionet e jashtme	0	779,481	222,130	28%	443,876	99,609

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,116,138€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së buxhetit përmes Financimit nga Huamarrja dhe donacionet, në anën tjetër kishte zvogëlim nga Granti i Qeverisë dhe të hyrave nga AKP me vendim të Qeverisë Nr. 03/115 si pasojë e mos shpenzimit të buxhetit.

Ndryshimi i buxhetit krahasuar me vitin e kaluar ishte si rezultat i reformimit të sektorit të shëndetësisë ku disa përgjegjësi kanë kaluar nga MSh-ja në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), siç është menaxhimi i listës esenciale të barnave me efekt në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu Fondi për Sigurime Shëndetësore nga viti 2019 ishte formuar si Organizatë buxhetore e pavarur.

Në vitin 2019, MSh-ja ka shpenzuar 64% të buxhetit final ose 26,153,128€, me një rënie prej 28% krahasuar me vitin 2018. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Kategoritë ekonomike	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimi 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Totali	39,863,808	40,979,946	26,153,128	64%	58,559,449	57,567,776
Pagat dhe Mëditjet	7,770,389	7,443,318	7,436,352	100%	8,050,649	8,313,972
Mallrat dhe Shërbimet	16,064,266	19,897,701	10,175,832	51%	34,337,305	29,506,459
Shërbimet komunale	227,348	227,348	157,332	69%	155,407	183,802
Subvencionet dhe Transferet	2,313,805	2,313,805	1,929,033	83%	11,016,744	14,350,049
Investimet Kapitale	13,488,000	11,097,774	6,454,579	58%	4,999,344	5,213,494

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 327,071€. Ndryshimet kanë ndodhur si pasojë e rritjes së buxhetit nga donacionet e jashtme për 37,956€, përderisa me vendim të Qeverisë si kursime buxhetore ishte zvogëluar buxheti për 365,027€;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar më buxhetin fillestar ishte rritur për 3,833,435€. Ndryshimet kanë ndodhur si pasojë e rritjes së buxhetit nga financimi i huamarrjes për projektin “Shëndetësia Kosovare” në vlerë 4,127,146€, donacioneve të jashtme për 638,795€, përderisa me vendim të Qeverisë si kursime buxhetore ishte zvogëluar buxheti për 932,506€; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,390,227€. Me vendim të Qeverisë si kursime buxhetore është zvogëluar buxheti për 2,492,957€, përderisa nga donacionet e jashtme kishte një rritje të buxhetit për 102,730€.

Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Siç kemi paraqitur te theksimi i çështjes, MSh në vitin 2019 përmes planifikimit buxhetor dhe vendimeve gjyqësore ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 299,894€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Pagesa në vlerë 189,020³€ për funksionalizimin e Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh) ishte realizuar nga Thesari bazuar në vendimin gjyqësor nga kategoria mallrave dhe shërbimeve, por që për nga natyra ky shpenzim i takon kategorisë së investimeve kapitale;
- Pagesat në vlerë 31,055€⁴ për kompensim të trajtimeve mjekësore jashtë vendit ishin realizuar nga Thesari bazuar në vendimet gjyqësore nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, por që për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë së subvencioneve. Ministria kishte informuar thesarin se dy pagesa për trajtime mjekësore duhet paguar nga Fondi për Sigurime Shëndetësore por meqë sipas urdhrorit për përmbarrim debitor ishte Ministria e Shëndetësisë pagesat ishin realizuar nga buxheti i MSh-së;
- Pagesat në vlerë 24,158⁵€ për kompensimin e pagave jubilarë ishin realizuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, por që për nga natyra këto shpenzime i takonin kategorisë së pagave dhe mëditjeve; dhe
- Pagesat në vlerë prej 55,661€ për servisimin e pajisjeve mjekësore kishin qenë të buxhetuara dhe ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale edhe pse këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.

³ Pagesa ka të bëjë me kontratën "Funksionalizimi i SISh-it, VOIP& Sistemi i menaxhimit të HPRO Kartelave"

⁴ Pagesat me kupon të shpenzimit: 181250 ; 139633 dhe 294243

⁵ Pagesat në vlerë prej 9,508€ ishte realizuar me vendim gjyqësor nga Thesari kurse pagesat në vlerë prej 14,650€ ishte realizuar sipas nenit 39.2 nga Thesari

Sipas zyrtarëve të ministrisë pagesat me vendime gjyqësore janë ekzekutuar direkt nga thesari dhe kishte raste që mjetet i ishin marrë Ministrisë pa njoftim nga thesari. Ministria gjatë vitit nuk ka ndërmarr masa për ridestinim të mjeteve sipas ligjit. Ndërsa pagesat për servisimin e pajisjeve sipas zyrtarëve të ministrisë ishin pasojë e buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime, e të cilat ishin të domosdoshme.

Ndikimi Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Një bashkëpunim efektiv me Ministrin e Financave do të lehtësonte gjetjen e zgjidhjeve, në mënyrë që të shmangen këto devijime.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara ishin në vlerë 4,868,318€. Ministria e Shëndetësisë arkëton të hyra nga këto shërbime: gjobat nga inspektorati, licencat për aktivitete individuale dhe të lira, licencat për produkte medicinale, shitja e shërbimeve, participimet, banderolat dhe inspektimi sanitar. Ministria nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e të hyrave të realizuara, por të gjitha arkëtimet e të hyrave derdhen në buxhetin e Kosovës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	4,282,200	4,282,200	4,868,318	114%	4,717,275	4,614,915

Çështja A2 - Arkëtimi i të hyrave mbi 10€ në të gatshme

Gjetja

Neni 11.1 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat, përcakton që të gjitha pagesat për shërbime në lartësi mbi 10€ duhet të bëhen përmes bankave komerciale / institucioneve financiare jo bankare të licencuara. Gjithashtu neni 11.2 përcakton se në fund të ditës paratë e grumbulluara në arkat e OB-ve duhet të depozitohen në bankë. Ne kemi gjetur se:

- Në IKSHPK Prishtinë - 15⁶ pagesa ishin inkasuar përmes arkës edhe pse vlera e pagesës ishte mbi 10€. Depozitimi i të hyrave në bankë është bërë pas pesë (5) dite;
- Në IKSHPK Gjilan - 25⁷ pagesa ishin inkasuar përmes arkës edhe pse vlera e pagesës ishte mbi 10€. Depozitimi i të hyrave në bankë është bërë pas tre (3) dite;
- Në IKSHPK Prizren - 19⁸ pagesa ishin inkasuar përmes arkës edhe pse vlera e pagesës ishte mbi 10€. Depozitimi i të hyrave në bankë është bërë pas katër (4) dite; dhe
- Në IKSHPK Ferizaj - 21⁹ pagesa ishin inkasuar përmes arkës edhe pse vlera e pagesës ishte mbi 10€. Depozitimi i të hyrave në bankë është bërë pas dy (2) dite.

Vlera e pagesave të pranuar përmes arkës kryesisht sillet nga 15€. Arkëtimi në para të gatshme i këtyre të hyrave kishte ndodhur për shkak se në objektet shëndetësore apo afër tyre nuk ka ndonjë bankë apo institucion financiar ku mund të kryhen pagesat. Depozitimi i të hyrave me vonesë ka ndodh për shkak të neglizhencës nga personat përgjegjës.

Ndikimi

Mos respektimi i kërkesave ligjore lidhur me mbledhjen e parave të gatshme, dhe trajtimi jo i duhur i menaxhimit të procesit të depozitimit të të hyrave mund të shkaktojë keqpërdorim të parasë së gatshme, dhe mund të rezultojë me humbje të tyre.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherëve të financave që mbledhja e të hyrave mbi 10€ të realizohet përmes llogarisë bankare si dhe depozitimi i tyre në bankë të bëhet në baza ditore. Nëse kjo është e përealizueshme atëherë si alternativë mbetet adresimi te Ministria e Financave për të ndryshuar rregulloren aktuale.

⁶ Të hyrat e dt. 16.04.2019 në vlerë prej 2,201 € kemi gjetur 15 pagesa të inkasuar në vlerë mbi 10 Euro

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 7,443,318€ i cili ishte realizuar 100%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,160 ndërsa në fund të vitit numri aktual ishte 864. Sipas zyrtareve përgjegjës arsytet e mosplotësimit të pozitave sa i përket specializanteve¹⁰ (223 pozita të lira) është mos shpallja e konkursit nga ana e Ministrisë përkundër kërkesave, ndërsa për departamentet tjera edhe përkundër se pozitat në ligj kanë qenë të aprovuara, buxheti ka qenë i pamjaftueshëm për to.

Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 42 punonjës të rinj. Kemi testuar 79 mostra për teste substanciale në vlerë 65,591€, si dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 20,125,049€ (përfshirë edhe buxhetin për shpenzime komunale), prej tyre ishin shpenzuar 10,333,164€. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzimet për blerjen e barnave, mirëmbajtje dhe shpenzime tjera. Kemi testuar 77 mostra për teste substanciale në vlerë 5,677,831€ si dhe shtatë mostra për teste të pajtueshmërisë.

⁷ Te të hyrat e dt. 10.01. 2019 në vlerë prej 202 € kemi gjetur 9 pagesa të inkasuar në vlerë mbi 10 Euro dhe Te të hyrat e dt. 12.04.2019 në vlerë prej 263 € kemi gjetur 16 pagesa të inkasuar në vlerë mbi 10 Euro

⁸ Te të hyrat e dt. 06.06. 2019 në vlerë prej 353 € kemi gjetur 18 pagesa të inkasuar në vlerë mbi 10 Euro dhe Te të hyrat e dt. 04.01.2019 në vlerë prej 22 € kemi gjetur 1 pagesë të inkasuar në vlerë mbi 10 Euro

⁹ Te të hyrat e dt. 07.0.2019 në vlerë prej 322 € kemi gjetur 21 pagesë të inkasuar në vlerë mbi 10 Euro

¹⁰ Në 2020 Ministria ka shpallur konkurs për profesionist shëndetësor .

Çështja A3 – Shpenzime shtesë si rezultat i pagesave me vendime gjyqësore/ përmbartimore

Gjetja

Neni 39 i LMFP përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjëse për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa pagat jubilarë dhe përcjellëse janë të rregulluara sipas Kontratës Kolektive Sektoriale.

Nga shqyrtimi i pagesave përmes vendimeve gjyqësore të Ministrisë, kemi identifikuar se si rezultat i mos pagesës së obligimeve me kohë për OE dhe përfituesit e pagave jubilarë, të njëjtit përmes procedurave gjyqësore i kishin realizuar të drejtat e tyre ligjore. Vlera e ekzekutuar nga Thesari të vendimeve gjyqësore ishte 276,040€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 237,429€ ndërsa shpenzimet procedurale të gjykatës (përmbartimit) dhe interesit ishin 38,611€.

MSh lëndët e trajtuara nga përmbartuesit i kishte kontestuar dhe i kishte dërguar deri në gjykatë, por edhe aty operatorët i kishin fituar rastet, përderisa te pagat jubilarë dhe përcjellëse sipas zyrtareve të ministrisë arsyet e mos pagesës me kohë ishte mungesa e buxhetit.

Ndikimi

Pagesat përmes vendimeve gjyqësore ndikojnë në rritjen e pa arsyeshme të shpenzimeve të ministrisë, pasi ministria nuk do të marrë në këmbim asnjë mall/shërbim për pjesën e shpenzimeve që tejkalon borxhin kryesor.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurojë që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur dhe të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione ishte 2,313,805€, prej tyre ishin shpenzuar 1,929,033€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e specializantëve dhe të organizatave joqeveritare. Kemi testuar 21 mostra për teste substanciale në vlerë 79,172€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 11,097,774€, prej tyre ishin shpenzuar 6,454,579€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve shëndetësore, zgjerimin e infrastrukturës për SISH, blerjen e pajisjeve mjekësore etj. Kemi testuar 46 mostra për teste substanciale në vlerë 4,460,377€, si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Ndryshimi i sasive të paramasës për kontratat jo kornizë pa aprovimin e ZKA-së

Gjetja Sipas nenit 61.23 të rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik “Ndryshimi i kontratës nuk do t’i lëshohet OE para marrjes së aprovimit nga ZKA”. Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit. Ndryshimet e sasive lejohen te kontratat kornizë.

Ne kemi vërejtur se te kontrata jo kornizë “Ndërrimi i dyerve të sallave të Emergjences dhe renovimi i Pritores së Emergjences në QKUK” në vlerë 114,217€ janë ndryshuar sasitë e realizuara nëpër disa pozicione, duke i rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar, por pa ndryshuar çmimin total të kontratës. Nga gjithsej 100 pozicione sa ishin në kontratë 23 janë ndryshuar. Aprovimet për këto ndryshime nuk ishin marr nga ZKA por vetëm nga menaxheri i kontratës.

Ndikimi Ndryshimi i paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar pa aprovimin e ZKA-së shpërfaq dobësitë e kontratës dhe kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave raportojnë çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës duke arsyetuar me analiza specifike këto ndryshime dhe paraprakisht duhet të marrin aprovimin nga zyra e prokurimit dhe ZKA.

Çështja A5 - Vonesa në procesin e vlerësimit të tenderëve

Gjetja Sipas nenit 41.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik “Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh.

Në procedurën e prokurimit “Furnizim me Pajisje Mjekësore” e cila ishte e përbërë nga 32 lloje kishte vonesa në vlerësim prej 84 ditë¹¹ që nga hapja e ofertave.

Sipas anëtarëve të komisionit vlerësues të tenderëve vonesat kishin ndodhur për shkak të kompleksitetit të procedurës ku për disa pajisje kane kërkuar sqarime shtesë nga OE.

Ndikimi Vonesat në vlerësim të tenderëve përveç anashkalimit të rregullave kanë ndikuar në vonesat në lidhje të kontratave e rrjedhimisht edhe shtyrjen e furnizimeve dhe marrjen e shërbimeve për qytetar.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave përfundohet brenda afateve të përcaktuara duke mundësuar që furnizimet të merren në kohën e paraparë. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse duhet të shtohen resurset e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.

¹¹ Hapja e ofertave ishte bërë me datë 27.09.2018 ndërsa vlerësimi i tenderëve kishte përfunduar me datë 21.12.2018

2.1.5 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B1- Realizim i ulët i projekteve kapitale dhe furnizimeve me mallra e shërbime

Gjetja Sipas buxhetit final për vitin 2019, Ministria kishte fonde për të realizuar 26 projekte kapitale në vlerë prej 11,097,774€ dhe për furnizim me mallra e shërbime (gjysma e buxhetit për furnizim me barna) 19,897,701€. Ne identifikua se:

- Niveli i shpenzimeve të projekteve kapitale ishte 58% në raport me buxhetin final. Nga 26 projektet e planifikuara 5 prej tyre nuk kishin shpenzime, përderisa 6 projekte kishin realizimin nga 3 deri 40%. Arsyeja e nivelit të ulët të realizimit të projekteve ishte planifikimi i dobët i projekteve dhe futja e projekteve në ligj të buxhetit, pa ndonjë analizë paraprake të mirëfilltë të projekteve. Po ashtu, kishte edhe raste kur janë ndërprerë kontratat me OE si pasojë e mos kryerjes së punëve sipas kontratës; dhe
- Niveli i shpenzimeve të mallrave e shërbimeve ishte 51% në raport me buxhetin final. Nga buxheti prej 10.3 mil€ për blerjen e barnave për nivelin parësor¹² shëndetësor ishin shpenzuar vetëm 5.4 mil€. Furnizimi me barna nuk ishte realizuar si rezultat i vonesave në fillimin e procedurave, ankesat në OSHP si dhe vonesat në nënshkrim të kontratave.

Ndikimi Niveli i ulët i realizimit të projekteve dhe furnizimit me barnave rezulton në shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion dhe e gjithë kjo ndikon në mos arritjen e objektivave të parapara dhe rrjedhimisht edhe në cilësinë dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të adresoj barrierat që po ndikojnë në nivelin e ulët të realizimit të buxhetit në këto kategori. Projektet duhet të jenë analizuar dhe me standardet e kërkuara para inicimit të procesit të prokurimit në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik. Po ashtu, te furnizimet me barna duhet eliminuar vonesat si në fillim të procedurave ashtu edhe në nënshkrimin e kontratave.

¹² Ministria e Shëndetësisë kryen blerjen e barnave për nivelin parësor, ndërsa ShSKUK kryen blerjen e barnave për nivelin dytësor dhe tretësor.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të ishte 8,851,815€, vlera e pasurisë jo kapitale ishte 428,412€, ndërsa stoqet në fund vit ishin 2,017,653€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 5,655,823€, si dhe teste të pajtueshmërisë.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF - Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive. Për stoqet kemi testuar mostrat nga stoku farmaceutik rreth regjistrimit të tyre në sistem si dhe menaxhimin e tyre.

Çështja B2 - Dobësi në regjistrin kontabël të pasurive

Gjetja

Menaxhimi i pasurive rregullohet me rregulloren MF - Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë (tani e tutje Rregullorja). Nga testimet tona dhe analizat e regjistrit të pasurive kemi verifikuar se pasuritë e Ministrisë ishin të mbivlerësuara për 58,013€ ndërsa të nënvlerësuara ishin për 1,309,372€. Informatat detaje mund të shihen si në vijim:

- Tri (3) pagesa në vlerë 1,271,514€¹³ nuk ishte evidentuar në regjistrin e pasurive, e që kjo është në kundërshtim me nenin 10 të Rregullores ku theksohet se të gjitha pasuritë, pas pranimit duhet të regjistrohen pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara;
- Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut (QKTGJ) kishte prezantuar pasuritë nën 1,000€ në vlerë 12,215€, përderisa vlera e saktë e tyre ishte 50,073€ (me një nënvlerësim prej 37,858€). QKTGJ si pasojë e gabimit teknik kishte raportuar vetëm blerjet e vitit 2019. Ky nënvlerësim ishte reflektuar edhe te PFV e Ministrisë; dhe
- Agjensioni i Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) kishte prezantuar pasuritë nën 1,000 në vlerë 121,692€, përderisa vlera e saktë e tyre ishte 63,679€ (me një mbivlerësim prej 58,013€). Kjo kishte ndodhur pasi që pasuritë e njëjta ishin regjistruar në dy regjistra. Ky mbi vlerësim ishte reflektuar edhe te PFV e Ministrisë. Gjithashtu pasuritë ishin raportuar pa llogaritur zhvlerësimin në kundërshtim me piken 3 të nenit 24 të Rregullores.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë rreth pasurisë dhe raportimi jo i duhur pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi mbi/nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi B2 Ministri, duhet të sigurojë se të gjitha njësitë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarët e pasurive që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale. Po ashtu, duhet siguruar trajnime adekuate për zyrtarët e pasurive me qëllim që kompetenca të jetë në nivelin e duhur për të shmangur të gjitha paqartësitë me të cilat ballafaqohen zyrtarët e pasurive.

¹³ Pagesa me kupon të shpenzimit 2019-192470 në vlerë 218,894€ pagesa me kupon të shpenzimit 2019-326,997 në vlerë 695,250€ si dhe pagesa me kupon të shpenzimit 2019-326911 në vlerë 357,370€.

2.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Sipas shënimeve të thesarit dhe prezantimit në PFV, gjendja e avanceve për udhëtime zyrtare të hapura në Ministri për 2019 është 720,038€. Meqenëse problematika e avanceve të hapura është në procedura hetimore nga ana e organeve kompetente, ne nuk e kemi trajtuar këtë kategori.

2.4 Të arkëtueshmet

Ministria e Shëndetësisë kishte shpалosur në PFV, llogari të arkëtueshme (Ll/A) në vlerë prej 612,172€, apo për 293,258€ më shumë se vitin paraprak. Kjo vlerë përbehet nga Ll/A të prezantuara nga QKTGJK, IKSHP, AKPPM, Inspektoriat Shëndetësor dhe Farmaceutik.

Çështja B3 - Mangësi në raportim dhe menaxhim të Llogarive të Arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 16 të Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar “Organizatrat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave”. Nga testimet dhe analizat në regjistra kemi identifikuar se Ll/A ishin të mbivlerësuara për 189,481€. Informatat nga Agjencionet janë bartur gabimisht në PVF-të e MSh gjatë konsolidimit dhe detajet mund të shihen si në vijim:

- AKPPM kishte deklaruar vlerën e Ll/A prej 37,633€ ndërsa Ministria në PFV kishte prezantuar 123,000€. Pas analizimit të regjistrit ne verifikuam se vlera e saktë e Ll/A të AKPPM ishte 26,786€;
- QKTGJ kishte deklaruar vlerën e Ll/A prej 46,733€ ndërsa Ministria në PFV kishte prezantuar vlerën 13,200€;
- Inspektoriat Shëndetësor kishte deklaruar vlerën e Ll/A prej 185,400€ ndërsa Ministria në PFV kishte prezantuar vlerën 231,700€; dhe
- Inspektoriat Farmaceutik kishte deklaruar vlerën e Ll/A prej 74,500€ ndërsa Ministria në PFV kishte prezantuar vlerën 155,000€.

Mosprezentimi i drejtë i llogarive të arkëtueshme nga njësitë kishte ndodhur për shkak të gabimeve teknike, neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës për regjistrimin, ruajtjen dhe prezentimin e drejtë dhe të plotë të Ll/ A dhe ndryshimet e shpeshta të zyrtarëve përgjegjës. Mangësitë kanë ndodh si rezultat i kontrolleve jo efikase në këtë fushë nga Ministria e Shëndetësisë.

Ndikimi Raportimi jo i duhur pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi Llogaritë e arkëtueshme. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi mbi deklarim të Ll/A duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave se konsolidimi i të dhënave nga agjencionet i nënshtrohet një rishikimi të plotë të saktësisë së të dhënave dhe gabimet parandalohen me qëllim që prezantimi i llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë në PFV.

2.5 Detyrimet

2.5.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 214,896€ prej tyre fatura me afat për pagese më pak se 30 ditë 210,128€ dhe 4,768€ më shumë se 30 ditë. Krahasuar me vitin paraprak kemi rënie të theksuar të detyrimeve nga fakti që FSSH ishte pavarësuar si OB dhe vlera më e madhe ishin detyrime për trajtimin e pacientëve jashtë vendit. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

Çështja C1 - Vonesa në pagesat e faturave

Gjetja Sipas nenit 37.1 të Rregullës financiare nr. 01/2013 MF Shpenzimi i parasë publike, të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve.

Në katër ¹⁴ nga 10 mostra të testuara kishte vonesa në pagesa, këto vonesa ishin deri 70 ditë përtej afatit ligjor.

Në bazë të raportit për punët e kryera të pranuar nga menaxheri i kontratës vërehet që të gjitha shërbimet janë bërë sipas kontratës.

Ndikimi Vonesat në realizimin e pagesave mund të ndikojnë që Ministria të jetë objekt i padive gjyqësore dhe mund të bartë edhe shpenzime shtesë. Gjithashtu, mund të pasojnë edhe me pagesa direkte nga thesari që reflektojnë harxhimin e mjeteve që janë destinuar për qëllime tjera.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të sigurojë që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur ministria paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

¹⁴ Pagesa në vlerë 1,500€ "SERVISIMI I APARAT.MJEKSORE" ishte paguar me 69 ditë vonesë; Pagesa në vlerë 4,162.96€ "SERV I APARATUR MJEKSORE" ishte paguar me 70 ditë vonesë; Pagesa në vlerë 4,306.16€ "SERV I APARAT MJEKS" ishte paguar me 68 ditë vonesë; dhe Pagesa në vlerë 27,832.89€ "VALIDIM SERVISIM" ishte paguar me katër (4) ditë vonesë.

2.5.2 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2019 të shpalosura në PFV ishin vlerësuar rreth 1,178,758€. Nga analizimi i të dhënave kemi identifikuar mangësitë në prezantimin e tyre.

Çështja A6 - Nënvlërësim i detyrimeve kontingjente

Gjetja Sipas nenit 3.1.1 të rregullores MF - nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar “Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen”. Ministria kishte nënvlerësuar vlerën e detyrimeve kontingjente për 256,497€ për arsye se zyra ligjore kishte raportuar te ZKF vetëm detyrimet e vitit 2019. Pra nuk ishte përcjellur kronologjia e detyrimeve të bartura nga vitet paraprake të cilat ende ishin konteste. Gjithashtu sipas listës të dërguar nga burimet njerëzore në Ministri ishin 9 zyrtar të pezulluar, ndërsa nuk ishin raportuar në PFV si detyrime kontingjente pagat e tyre të mundshme.

Ndikimi Mos prezantimi i saktë dhe i plotë i obligimeve mund të shkaktoi paqartësi tek lexuesit dhe përdoruesit lidhur me përmbajtjen e PFV-ve dhe ngjarjeve ekonomike të ndodhura gjatë vitit.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave që kryhet rishikimi i plotë i të dhënave në lidhje me detyrimet kontingjente si dhe prezantimi i tyre në PFV të jetë në përputhje me informatat e sakta.

2.5.3 Detyrimet kontraktuale

Bazuar në informatat e siguruar nga Ministria, detyrimet kontraktuale ishin në vlerë prej 20,192,409€. Rreth 46% kanë të bëjnë me projekte afatgjate si “Ndërtimi i Spitalit në Ferizaj”, “Zgjerimi i Infrastruktures Ekzistuese për SISH”, “Ndërtimi i QKMF në Gjilan”. Pjesa tjetër ka të bëjë me kontrata kornizë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

2.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) përbëhet nga drejtori dhe dy auditor. NjAB-i, kishte hartuar planin vjetor të punës ku ishin planifikuar 11 auditime, të cilat edhe ishin realizuar gjatë vitit.

Raportet e auditimit të brendshëm kishin rezultuar me 45 rekomandime. Prej tyre 24 rekomandime janë zbatuar, 7 ishin në proces dhe 14 ende nuk janë zbatuar. Auditimet e planifikuara kishin fushëveprim kryesisht vitin 2018 dhe 2019 dhe kanë mbuluar auditime si menaxhimi i kontratave, mbështetja financiare e OJQ-ve, menaxhimi i pasurisë, projekti Shëndetësia Kosovare.

NjAB kishte raportur në NjQH-AB duke përfshirë këtu realizimin e raporteve, numrin e rekomandimeve të dhëna si dhe sa prej tyre janë implementuar.

Komiteti i Auditimit gjatë vitit kishte mbajtur pesë takime ku kishin nxjerr konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e sistemit të NjAB-së.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 ka rezultuar me nëntë rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Ministria e Shëndetësisë ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (shtator 2019 dhe mars 2020) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, tri rekomandime janë zbatuar, një rekomandim është adresuar pjesërisht, dy¹⁵ rekomandime nuk ishin adresuar dhe tri rekomandime janë konsideruar të mbyllura (Tri rekomandime e mbyllura i takojnë Fondit të Sigurimeve Shëndetësore FSSH) dhe do të trajtohen në raportin e auditimit të FSSH-së. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

¹⁵ Në raportin e auditimit 2018 te pjesa e pasqyrave është dhënë një rekomandim që ka përfshirë pasuritë dhe LI/A. Ky rekomandim ndërlidhet me rekomandimin B2 dhe B3 në këtë raport.

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të siguroj se do të bëhet regjistrimi i të gjitha pasurive kapitale dhe jo kapitale si dhe raportimin e të gjitha llogarive të arkëtueshme.	Edhe në vitin 2019 kishte pasuri të blera që nuk ishin regjistruar. Ndërsa sa i përket llogarive të arkëtueshme nuk janë marr veprime.	Rekomandim i pazbatuar
2	Planifikim i dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të përcaktoj një dinamikë më të përshtatshme të aktiviteteve, të përmirësoj kontrollet në fushën e kontraktiveve, mbikëqyrjes dhe realizimit të projekteve për tu siguruar se ato realizohen sipas planit të parashikuar.	Nuk janë ndërmarr veprime edhe këtë vit realizimi i buxhetit është në nivel të ulët.	Rekomandim i pazbatuar
3	Paga dhe Mëditje	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve duke bërë monitorimin e vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Nëse problemi nuk mund të zgjidhet brenda ministrisë, kjo duhet të diskutohet në nivel të Qeverisë dhe të nxirren vendimet e duhura.	Menaxhmenti e ka trajtuar këtë çështje. Nga dëshmitë e ofruara punonjësit janë nënshkruar në lista të vajtje-ardhjes për vitin 2019.	Rekomandim i zbatuar
4	Mallra dhe Shërbime	Ministri duhet të siguroj se Drejtori Ekzekutiv i QKTGJ-së zbaton me konsistencë kërkesat e rregulloreve dhe formon me kohë komisionet për pranimin e mallrave dhe pasurive të blera jo financiare.	Nga testimi i pagesave për vitin 2019 kemi vërtetuar se në të gjitha rastet është formuar komisioni për pranimin e mallrave.	Rekomandim i zbatuar
5	Mallra dhe Shërbime	Ministri duhet të siguroj se Drejtori Ekzekutiv i QKTGJ-së do të përmbushë kërkesën ligjore që të gjithë menaxherët e kontratave pas përfundimit të kontratave të përgatisin	Gjatë testeve të këtij viti ne nuk kemi hasur në raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar

		raporte të hollësishme konform rregulloreve të prokurimit.		
6	Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet menjëherë të krijojë një komision për të zbatuar një proces të harmonizimit që do të mbulojë të gjitha spitalet private, dhe se çdo fond që u paguhet këtyre spitaleve dhe që tejkalon shpenzimet aktuale të trajtimit, duhet të kthehet në MSh.	Ky rekomandim është për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Meqë Fondi nga viti 2019 është organizatë në veti veprimet e ndërmarra do të trajtohen në raportin për FSSh 2019.	Rekomandim i mbyllur
7	Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të krijojë mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese janë duke e respektuar obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara nga ministria.	Ky rekomandim është për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Meqë Fondi nga viti 2019 është organizatë në veti veprimet e ndërmarra do të trajtohen në raportin për FSSh 2019	Rekomandim i mbyllur
8	Obligimet e pa paguara	Ministri duhet të sigurojë se njësitë e MSh-së faturat i evidentojnë dhe pranojnë përmes protokollit dhe se të njëjta regjistrohen dhe procedohen me kohë për pagesë.	Nga testimet këtë vit nuk kemi hasur në raste të mos protokollimit, por kemi hasur në vonesa në pagesën e faturave. Shih rekomandimin C1	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
9	Obligimet e pa paguara	Ministri të sigurojë se Bordi ekzekutiv i TMJShP me rastin e aprovimit të kërkesave për trajtim të pacientëve, duhet të marrë në konsiderim fondet buxhetore në dispozicion dhe të mos aprovohet kërkesa që krijojnë obligime për vitet vijuese.	Ky rekomandim është për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Meqë Fondi nga viti 2019 është organizatë në veti veprimet e ndërmarra do të trajtohen në raportin për FSSh 2019.	Rekomandim i mbyllur

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019
1	Planifikim i dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Një bashkëpunim efektiv me Ministrin e Financave do të lehtësonte gjetjen e zgjidhjeve, në mënyrë që të shmangen këto devijime.
2.	Të Hyrat	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherëve të financave që mbledhja e të hyrave mbi 10€ të realizohet përmes llogarisë bankare si dhe depozitimi i tyre në bankë të bëhet në baza ditore. Nëse kjo është e porealizueshme atëherë si alternativë mbetet adresimi te Ministria e Financave për të ndryshuar rregulloren aktuale.
3.	Mallrat dhe Shërbimet	Ministri duhet të sigurojë që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur dhe të gjitha faturat e pranuarat paguhen brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.
4.	Investimet Kapitale	Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave raportojnë çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës duke arsyetuar me analiza specifike këto ndryshime dhe paraprakisht duhet të marrin aprovimin nga zyra e prokurimit dhe ZKA.
5.	Investimet Kapitale	Ministri duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave përfundohet brenda afateve të përcaktuara duke mundësuar që furnizimet të merren në kohën e paraparë. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse duhet të shtohen resurset e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.
6.	Çështjet e përbashkëta për M&SH dhe IK	Ministri duhet të adresoj barrierat që po ndikojnë në nivelin e ulët të realizimit të buxhetit në këto kategori. Projektet duhet të jenë analizuar dhe me standardet e kërkuara para inicimit të procesit të prokurimit në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik. Po ashtu, te furnizimet me barna duhet eliminuar vonesat si në fillim të procedurave ashtu edhe në nënshkrimin e kontratave.
7.	Pasuritë Kapitale dhe jokatitale	Ministri, duhet të sigurojë se të gjitha njësitë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarët e pasurive që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale. Po ashtu, duhet siguruar trajnime adekuate për

		zyrtarët e pasurive me qëllim që kompetenca të jetë në nivelin e duhur për të shmangur të gjitha paqartësitë me të cilat ballafaqohen zyrtarët e pasurive.
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave se konsolidimi i të dhënave nga agjencionet i nënshtrohet një rishikimi të plotë të saktësisë së të dhënave dhe gabimet parandalohen me qëllim që prezantimi i llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë në PFV.
9.	Detyrimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur ministria paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.
10	Detyrimet kontingjente	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave që të kryhet rishikimi i plotë i të dhënave në lidhje me detyrimet kontingjente si dhe prezantimi i tyre në PFV të jetë në përputhje me informatat e sakta.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE-NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATI PRANORIT/DATE DATED/PROCESSED ON 16.07.2020			
Niveli Org. Org. Unit 03	Shif. Klasif. Class. Code 47	Nr. Prot. Prot. No. 1110	Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages 1



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org. Unit 02	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No. 05-4442
Nr. faqeve Br. stranica No. pages -1-	Data: Datum: Date: 16.07.2020
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Ured Generalnog Sekretara/Office of the Secretary General

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Datë: 16.07.2020

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Prof. Asoc. Dr. Milazim Gjocaj

UD Sekretar i Përgjithshëm.

Ministria e Shëndetësisë,

